



Prishtinë, 27 gusht 2020

## KOMUNIKATË

nga

### SEANCA E VI PËR KËTË VIT, E BORDIT TË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Sot , me 27 gusht, 2020, Bordi i Rregullatorit për Energji, ka mbajtur seancën e tij të gjashtë (VI) me radhë për këtë vit.

Në këtë seancë Bordi ka miratuar Procedurën për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, të përgatitur nga Ndërmarrja Publike (NP) "Termokos" Sh.A. në Prishtinë. Kjo procedurë është përgatitur në përputhje me obligimin e përcaktuar në nenin 6.3 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, dhe përcakton veprimet që duhet ndërmarrë NP "Termokos" lidhur me zgjidhjen e ankesave të parashtruara të konsumatorëve ndaj shërbimit të furnizimit me energji termike (ngrohje qendrore).

Gjithashtu, në këtë seancë, Bordi i ZRRE ka shqyrtuar Raportin e monitorimit të NP Termokos Sh.a. ku janë paraqitur në formë të përmbledhur informatat dhe të dhënat e monitorimit të kësaj ndërmarrje për realizimet në sezonin 2019/2020. Raporti i monitorimit do të jetë i qasshëm për publikun në faqen e internetit të ZRRE.

Pjesë e shqyrtimit nga Bordi, në këtë seancë kanë qenë kërkesat e gjashtë (6) konsumatorëve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum të energjisë elektrike nga panelet solare. Kapacitetet e lejuara, bazuar në kërkesat e këtyre konsumatorëve janë në një total prej 255.85 kW dhe do të ndërtohen në komunën e Gjakovës, Pejës, Prishtinës, Ferizajt, Malishevës dhe Rahovecit.

Bordi ka shqyrtuar dhe gjashtë (6) ankesa të konsumatorëve si dhe disa çështje të tjera që ndërlidhen me funksionimin e Zyrës së Rregullatorit dhe sektorin e energjisë në përgjithësi.

*Të gjitha vendimet e Bordit të ZRRE publikohen në faqen zyrtare [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org) .*